

## VENDIM

Nr. 546, datë 27.7.2016

### **PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA TOKË BUJQËSORE NË TOKË TRUALL, PËR NDËRTIMIN E STACIONIT TË TRANSFERIMIT TË MBETJEVE TË BASHKISË POGRADEC<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me VKM nr.91, datë 8.2.2017)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr.8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga tokë bujqësore në tokë truall, të sipërfaqes prej 5 900 (pesë mijë e nëntëqind) m<sup>2</sup>, me vendndodhje sipas të dhënave në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e Stacionit të Transferimit të Mbetjeve të Bashkisë Pogradec.

2. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në Qarkun e Korçës, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit, nga tokë bujqësore (arë) në tokë truall, për sipërfaqen prej 5 900 (pesë mijë e nëntëqind) m<sup>2</sup>, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Qarkut Korçë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

---

<sup>1</sup> VKM nr.546, datë 27.7.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.145, 3 gusht 2016.  
VKM nr.91, datë 8.2.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.25, 16 shkurt 2017.

## TOKË BUJQËSORE (KATEGORIA VIII)

Bashkia	Njësia administrative	Fshati	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Pronari	Lloji i pasurisë	Kategoria e tokës bujqësore	Truall i kërkuar (m <sup>2</sup> )
Pogradec	Çërravë	<i>Leshnicë</i>	2420	77	tokë shtet	arë	VIII-të	5900

